LIGJ
Nr. 88/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË RRUGËS TIRANË–ELBASAN–QUKËS–QAFA E PLLOÇËS, "HUA SHTESË"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për projektin e ndërtimit të rrugës Tiranë–Elbasan–Qukës–Qafa e Plloçës, "Hua shtesë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2022.

Shpallur me dekretin nr. 4, datë 10.1.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE HUAJE
PROJEKTI I NDËRTIMIT TË RRUGËS TIRANË–ELBASAN–QUKËS–QAFA E PLLOÇËS, "HUA SHTESË", NDËRMJET FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
HUAJA NR. 5/782, NËNSHKRUAR NË DATËN 12/01/1444 AH QË I KORRESPONDON DATËS 10.8.2022 AD

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës 12/01/1444 A.H. që i korrespondon datës 10.8.2022 AD ndërmjet:
1. Fondit Saudit për Zhvillim, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite (në vijim i referuar si "Fondi"), dhe
2. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Huamarrësi")

PREAMBULË

A. *Duke pasur parasysh se* Huamarrësi i ka kërkuar Fondit dhënien e një "Huaje Shtesë" për ta asistuar në Projektin e Ndërtimit të Rrugës (Tiranë–Elbasan–Qukës–Qafa e Plloçës) të përshkruar në skedulin nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim i referuar si "Projekti");

B. *Duke pasur parasysh se* qëllimi i Fondit është të asistojë vendet në zhvillim për zhvillimin e ekonomive të tyre dhe t'u ofrojë huat e kërkuara për zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre të zhvillimit;

C. *Duke pasur parasysh se* Fondi është i bindur për rëndësinë e Projektit dhe ndikimet e tij të favorshme për zhvillimin ekonomik të popullit mik të Shqipërisë; dhe

D. *Duke pasur parasysh se* Bordi i Drejtorëve të Fondit ka rënë dakord, duke pasur parasysh sa më lart, në bazë të rezolutës së tij nr. (1442/1) që t'i japë një Hua Shtesë Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar më poshtë;

si rrjedhojë, palët e kësaj marrëveshjeje bien dakord si vijon:

Neni I
Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

Seksioni 1.01 Palët e kësaj Marrëveshjeje pranojnë të gjitha dispozitat e Kushteve të Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Huas së Fondit, të lëshuara në bazë të rezolutës së Bordit të Drejtorëve të Fondit nr. 11/14 të datës Rajab 29, 1396 AH, që i korrespondon datës 26 korrik 1976 AD, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në të (Kushtet e mësipërme të Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Huas së Fondit, që në vijim referohen si "Kushtet e Përgjithshme").

Seksioni 1.02 Kudo ku përdoren në këtë Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, disa terma të përkufizuar në Kushtet e Përgjithshme dhe Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje, kanë kuptimet përkatëse që janë caktuar në të dhe termi "Agjenci Ekzekutuese" nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë përmes Autoritetit Rrugor Shqiptar në ngarkim të ekzekutimit të Projektit ose ndonjë agjenci të caktuar nga Huamarrësi.

Neni II
Huaja

Seksioni 2.01 Fondi bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas ose të referuara për një Hua në një shumë prej njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë (183,750,000) rialë sauditë.

Seksioni 2.02 Shuma e Huas mund të tërhiqet nga Huamarrësi, përmes Agjencisë Ekzekutuese, nga Llogaria e Huas, në përputhje me dispozitat e skedulit nr. 1 të kësaj Marrëveshjeje, siç ky skedul mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit dhe në pajtim me Procedurat për Tërheqjet e Huave të Fondit, për shpenzimet e kryera (ose, nëse Fondi bie dakord, të cilat do të kryhen), në lidhje me koston e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas.

Seksioni 2.03 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, merr përsipër të aplikojë të ardhurat e Huas ekskluzivisht për financimin e kostos së mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për realizimin e Projektit. Prokurimi i këtyre mallrave, punimeve dhe shërbimeve do të jetë në përputhje me Udhëzimet për Prokurimin e Mallrave dhe Kontraktimin për Ekzekutimin e Punimeve dhe Përdorimin e Konsulentëve të Institucioneve për Zhvillim, Anëtare të Grupit të Koordinimit. Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, siguron miratimin e Fondit para dhënies së kontratave që do të financohen nga të ardhurat e Huas dhe para kryerjes së ndonjë ndryshimi thelbësor në të ardhmen për ndonjë prej tyre.

Seksioni 2.04 Data e mbylljes së tërheqjes do të jetë data 31.12.2026 ose një datë tjetër që mund të përcaktohet nga palët në formë me shkrim të rënë dakord.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do të paguajë një tarifë huaje në normën prej dy përqindësh (2%) në vit mbi shumën e principalit të Huas së tërhequr dhe të papaguar.

Seksioni 2.06 Tarifa e Huas dhe tarifa të tjera, nëse ka, janë të pagueshme çdo gjashtë muaj në datat 15 mars dhe 15 shtator në çdo vit.

Seksioni 2.07 Afati i Huas është njëzet e pesë vjet, duke përfshirë një periudhë pesëvjeçare mospagimi. Huamarrësi do të shlyejë shumën e principalit të Huas, në përputhje me Skedulin e Amortizimit të përcaktuar në skedulin nr. 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01 a) Huamarrësi do të kryejë Projektin, nëpërmjet Agjencisë Ekzekutuese, me kujdesin dhe efektshmërinë e duhur dhe në përputhje me praktikat e duhura inxhinierike, financiare dhe administrative dhe do të ofrojë ose do të marrë masa për ofrimin brenda një kohe të shpejtë të nevojshme, të fondeve, shumave dhe burimeve të tjera të nevojshme për qëllimin.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit "a" të këtij seksioni, Huamarrësi: 1. do të ofrojë menjëherë dhe në mënyrën dhe kohën e nevojshme, përveç të ardhurave të kësaj Huaje, të gjitha fondet e tjera që do të kërkohen për realizimin e Projektit (duke përfshirë fonde që mund të kërkohen për të mbuluar ndonjë rritje në koston e Projektit mbi koston e llogaritur të tij në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje), të gjitha ato shuma që do të vendosen në dispozicion, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Fondin; 2. do të marrë përsipër të kryejë alokime të mjaftueshme vjetore buxhetore për të mbuluar pjesën e tij të kostove të Projektit.

Seksioni 3.02 Huamarrësi do të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese t'i japë Fondit menjëherë pas përgatitjes së tyre, specifikime të planeve, raporte, dokumente kontratash dhe skedule ndërtimi dhe prokurimi për Projektin dhe çdo ndryshim ose shtesa të tyre, në hollësi të tilla që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 3.03 Huamarrësi do të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese të punësojë konsulentë sauditë të kualifikuar dhe me përvojë, të pranueshëm për Fondin, me qëllim që të asistojnë në tenderimin e Projektit dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të Projektit.

Seksioni 3.04 Huamarrësi do të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese të punësojë kontraktues, furnizues kompetentë dhe të kualifikuar sauditë dhe të përdorë produkte të tilla në realizimin e Projektit, të pranueshme për Fondin në bazë të termave dhe kushteve të kënaqshëm për Fondin.

Seksioni 3.05 Huamarrësi do të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese të sigurojë ose të marrë masa të mjaftueshme për sigurimin e mallrave të importuara që do të financohen nga të ardhurat e Huas kundër incidenteve të rreziqeve për blerjen, transportin dhe dorëzimin e tyre në vendin e përdorimit ose instalimit dhe për një siguracion të tillë, çdo dëmshpërblim do të jetë i pagueshëm në një valutë lirisht të përdorshme nga Huamarrësi për zëvendësimin ose riparimin e mallrave të tilla.

Seksioni 3.06 Huamarrësi do të përdorë ekskluzivisht të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e realizimit të Projektit.

Seksioni 3.07 Huamarrësi merr përsipër të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të treguar progresin e Projektit (duke përfshirë koston e tij), identifikuar mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas dhe informuar për përdorimin e tyre në Projekt, si edhe për të reflektuar të gjitha veprimet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me Projektin;

Seksioni 3.08 Huamarrësi dhe Agjencia Ekzekutuese marrin përsipër që t'i japin të gjithë mundësinë e arsyeshme përfaqësuesve të akreditуar të Fondit për të kryer vizita për qëllimet e lidhura me Huan, për të shqyrtuar Projektin, mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas dhe të dhëna dhe dokumente përkatëse.

Seksioni 3.09 Huamarrësi do të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese t'i sigurojë Fondit të gjithë informacionin që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me Projektin, shpenzimet e të ardhurave të Huas dhe mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga këto të ardhura.

Seksioni 3.10 Huamarrësi do të marrë masa që do të jenë të nevojshme për blerjen e të gjithë këtij trualli dhe të drejtat, në lidhje me truallin që do të kërkohen për realizimin e Projektit.

Seksioni 3.11 Huamarrësi do të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese të caktojë një Njësi për Zbatimin e Projektit që përbën elemente me kualifikim dhe me përvojë të nivelit të lartë në të gjitha specialitetet teknike dhe administrative, të nevojshëm për koordinimin dhe ndjekjen e aktiviteteve të ekzekutimit të Projektit.

Neni IV
Angazhime të veçanta

Seksioni 4.01 a) Huamarrësi dhe Fondi konfirmojnë angazhimin e tyre se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë përparësi mbi Huan, me anë të një barre të krijuar mbi asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që përveç kur Fondi bie dakord ndryshe, nëse krijohet barrë mbi ndonjë pasuri të Huamarrësit si garanci për ndonjë borxh të jashtëm, një barrë e tillë do të garantojë

ipso facto (në mënyrë faktike) dhe pa asnjë kosto për Fondin, në mënyrë të barabartë dhe të detyrueshme, pagesën e principalit të Huas, Tarifës së Huas dhe tarifave të tjera mbi Huan dhe se në krijimin e ndonjë barre të tillë do të bëhet parashikim i shprehur për këtë qëllim.

b) Sipërmarrja e parashikuar në paragrafin "a" të këtij seksioni nuk do të zbatohet, për:

1. Ndonjë barrë të krijuar mbi pronën, në kohën e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së një prone të tillë;

2. Ndonjë barrë mbi mallrat tregtare, për të garantuar një borxh që maturohet jo më shumë se një vit nga data në të cilën ka lindur fillimisht dhe që duhet të paguhet nga të ardhurat e shitjes së mallrave të tilla tregtare; ose

3. Ndonjë barrë që lind gjatë rrjedhës së zakonshme të transaksioneve bankare dhe që garanton një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

Seksioni 4.02 Aktivet, fondet dhe pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje që i alokohen Huamarrësit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të gjitha mallrat e prekshme dhe të paprekshme, nuk i nënshtrohen konfiskimit, një urdhri gjykate për ngrirje ose ndonjë forme tjetër konfiskimi si rezultat i veprimit përmbarimor kundër Huamarrësit ose që rezultojnë nga procedura të tjera gjyqësore në favor të një pale tjetër.

Seksioni 4.03 Huamarrësi merr përsipër të marrë masa që Agjencia Ekzekutuese të përgatisë një pllakë përkujtimore me dimensione të përshtatshme, me çimento ose metal të përshtatshëm, për t'u fiksuar në një vend të dukshëm në një nga objektet e përfshira në Projekt, për të treguar kontributin e Fondit në financimin e projektit.

Seksioni 4.04 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të mirëmbajë Projektin, në përputhje me standardet e duhura inxhinierike. Huamarrësi përmes Agjencisë Ekzekutuese i dorëzon Fondit, sipas kërkesës, një program për mirëmbajtjen në fjalë.

Seksioni 4.05 Huamarrësi merr masa që Agjencia Ekzekutuese të ruajë ose të marrë masa për ruajtjen e të dhënave të përshtatshme për të pasqyruar, në përputhje me praktikat e qëndrueshme të kontabilitetit, operacionet, burimet dhe agjencitë e tjera të huamarrësit që janë përgjegjëse për realizimin e Projektit ose ndonjë pjese të tij.

Seksioni 4.06 Menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes, ose në një datë të tillë të mëvonshme që Fondi mund të bie dakord për këtë qëllim, Huamarrësi përmes Agjencisë Ekzekutuese përgatit dhe i paraqet Fondit një raport të plotë të Projektit, në formë dhe detaje të tilla që Fondi kërkon në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe funksionimin fillestar të Projektit, kostot e tij dhe përfitimet e nxjerra dhe që do të rrjedhin prej tij, përmbushjen e detyrimeve nga Huamarrësi përmes Agjencisë Ekzekutuese, sipas Marrëveshjes së Huas dhe arritjen e objektivave të Huas.

Neni V
Mjetet ligjore të Fondit

Seksioni 5.01 Për qëllimet e seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme, rastet e mëposhtme shtesë janë specifikuar në përputhje me paragrafin "f" të tij:

a) Sipas nënseksionit "b" të këtij seksioni:

1. E drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e ndonjë Huaje të dhënë Huamarrësit për financimin e Projektit do të jetë pezulluar, anuluar ose përfunduar plotësisht ose pjesërisht, në përputhje me kushtet e parashikuara në Marrëveshje; ose

2. Ndonjë hua e tillë do të jetë bërë e kërkueshme dhe e pagueshme para maturimit të saj të rënë dakord.

b) Nënseksioni "a" i këtij seksioni nuk zbatohet, nëse Huamarrësi vërteton, sipas pëlqimit të Fondit, se: 1. Ky pezullim, anulim, përfundim ose përfundim i parakohshëm nuk është shkaktuar nga paaftësia e Huamarrësit për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij, sipas marrëveshjes specifike; dhe 2. Fondet e përshtatshme për Projektin janë në dispozicion për Huamarrësin nga burime të tjera, mbi termat dhe kushtet, në përputhje me detyrimet e Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve të Përgjithshme, rasti i mëposhtëm specifikohet në përputhje me paragrafin "d" të tij, përkatësisht ndodh çdo rast i specifikuar në paragrafin "a"/2 të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI
Data e hyrjes në fuqi – përfundimi

Periudha prej gjashtë muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje përcaktohet në këtë Marrëveshjeje për qëllimet e seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni VII
Përfaqësimi i Huamarrësit, Adresat

Seksioni 7.01 Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit, për qëllimet e seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimin e seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

PËR FONDIN:

Fondi Saudit për Zhvillim
P.O.Box 50483
Riyadh 11523
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel : +966-11-2794000
Faks : +966-11-4647450
E-mail : info@sfd.gov.sa

PËR HUAMARRËSIN:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel: +35542228405
E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

AGJENCIA EKZEKUTUESE
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga "Sami Frashëri", nr. 33, Tiranë
Tel/Faks: +355 4 22 5 9896
E-mail: pmuqqp3@yahoo.com

Në dëshmi të kësaj, Palët e këtushme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar sipas rregullave, kanë marrë masa që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës, në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër, në dy kopje në gjuhën arabe dhe angleze, ku secila do të jetë origjinale dhe dy kopje të Kushteve të Përgjithshme në gjuhët arabe dhe angleze i janë dhënë Huamarrësit.

Për Fondin Saudit për Zhvillim	Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Nga Sultan A. Almarshad Zyrtari kryesor Ekzekutiv	Nga znj. Delina Ibrahimaj Ministër i Financave dhe Ekonomisë

SKEDULI NR. 1
TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUAS

A. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e zërave që do të financohen nga të ardhurat e Huas, alokimi i shumës së Huas për secilën kategori dhe përqindja e shpenzimeve për zërat që do të financohen në secilën kategori:

Kategoria		**Shuma e alokuar (në rialë sauditë)**	**Përqindja e shpenzimeve që do të financohen**
1	Punimet Civile (pjesa dy, seksioni 3 i Projektit)	161,000,000	100% të shpenzimeve totale
2	Shërbime këshillimi (D i Projektit)	7,500.000	100% të shpenzimeve totale
3	Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP) (e katërta e Projektit)	250.000	100% të shpenzimeve totale
4	Të pashpërndara	15,000,000	
TOTALI		**183,750,000**	

B. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit A më lart, asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me pagesat e kryera, për:

1. Shpenzimet para datës së kësaj Marrëveshjeje;

2. Taksat e vendosura nga ose në territorin e Huamarrësit për mallra, punime ose shërbime, ose për importimin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre.

C. Pavarësisht nga alokimi i një shume të Huas ose përqindjet e disbursimit të paraqitura në tabelë në paragrafin A më lart, nëse Fondi ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e Huas e alokuar për kategorinë do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të të gjitha shpenzimeve në atë kategori, Fondi, me njoftim për Huamarrësin, mund:

1. Të rialokojë për një kategori të tillë, në masën që kërkohet për të përmbushur mungesën e parashikuar, të ardhurat e Huas, të cilat janë të paalokuara ose alokuara në një kategori tjetër dhe, që sipas opinionit të Fondit, nuk janë të nevojshme për të përmbushur shpenzimet e tjera; dhe

2. Nëse një rialokim i tillë nuk mund të përmbushë plotësisht mungesën e vlerësuar, zvogëlon përqindjen e disbursimit të zbatueshëm për shpenzimet e tilla, në mënyrë që tërheqjet e mëtejshme nënkategori të mund të vazhdojnë derisa të bëhen të gjitha shpenzimet më pas.

SKEDULI NR. 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Kjo Hua konsiderohet të përfundojë Pjesën e Dytë të Rrugës (Qukës–Qafa e Plloçës), me qëllim sigurimin e lidhjes më të shkurtër të rrugës midis kryeqytetit dhe fshatrave të izoluar me vendet fqinje jugore, si dhe të përmbushë kërkesat aktuale dhe të ardhshme të transportit, të përmirësojë rrugët për të tërhequr turizmin dhe biznesin. Projekti përbëhet nga sa vijon:

Së pari – Punimet Civile, të cilat përfshijnë dy pjesë:

Pjesa e parë: Rruga (Tiranë–Elbasan).

Ndërtimi i rrugës së re me dy korsi në çdo kah nga kryeqyteti (Tiranë) deri në Elbasan, me gjatësi 27 km dhe gjerësi totale 28.2 m, duke përfshirë tunel me dy korsi me gjatësi 2.2 km dhe gjerësi 9 m për secilën anë.

Pjesa e dytë: Rruga (Qukës–Qafa e Plloçës).

Ndërtimi i një rruge të re me 2 korsi me gjatësi 43.4 km, duke përfshirë një tunel rrugor me 375 m të gjatë me dy kahe. Rruga do të ketë dy korsi trafiku 3.75 metra të gjera, bankina të shtruara 1.5 metra dhe anët e bankina të paasfaltuara 1.0 metër në secilën anë. Përbëhet nga seksionet e mëposhtme:

Seksioni 1: Nga fillimi deri në pikën 2.9 km.

Seksioni 2: Nga pika 2.9 km deri në pikën 33.8 km, përfshirë tunelin e rrugës me dy kalime me gjatësi 375 metra.

Seksioni 3: Nga pika 33.8 deri në pikën 43.4 km (fundi i Projektit).

Së dyti – Shërbime këshilluese të projektit

Përgatitja dhe rishikimi i modelit, përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe mbikëqyrja e projektit, si më poshtë:

a) shërbime këshillimi për pjesën e parë të Projektit

b) shërbime këshillimi për pjesën e dytë të Projektit (seksioni 1)

c) shërbime këshillimi për pjesën e dytë të Projektit (seksioni 2)

d) shërbime këshillimi për pjesën e dytë të Projektit (seksioni 3)

Së treti – Blerja e Tokës

Së katërti – Njësia e Menaxhimit të Projektit (NJMP)

Përfshin mbulimin e mbështetjes logjistike për shpenzimet operative për stafin e njësisë.

Kostoja totale e Projektit për seksionin 3 që financohet nga Fondi është rreth 74 milionë dollarë amerikanë, që është e barabartë me 277,5 rialë saudite dhe Projekti pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2025.

SKEDULI NR. 3
SKEDULI I AMORTIZIMIT

Numri i këstit	Data e pagesës	Shuma e këstit (Shprehur në rialë sauditë)
1.	15/09/2027	4,584,000.00
2.	15/03/2028	4,594,000.00
3.	15/09/2028	4,594,000.00
4.	15/03/2029	4,594,000.00
5.	15/09/2029	4,594,000.00
6.	15/03/2030	4,594,000.00
7.	15/09/2030	4,594,000.00
8.	15/03/2031	4,594,000.00
9.	15/09/2031	4,594,000.00
10.	15/03/2032	4,594,000.00
11.	15/09/2032	4,594,000.00
12.	15/03/2033	4,594,000.00
13.	15/09/2033	4,594,000.00
14.	15/03/2034	4,594,000.00
15.	15/09/2034	4,594,000.00
16.	15/03/2035	4,594,000.00
17.	15/09/2035	4.594,000,00
18.	15/03/2036	4,594,000.00
19.	15/09/2036	4,594,000.00
20.	15/03/2037	4,594,000.00
21.	15/09/2037	4,594,000.00
22.	15/03/2038	4,594,000.00
23.	15/09/2038	4,594,000.00
24.	15/03/2039	4,594,000.00
25.	15/09/2039	4,594,000.00
26.	15/03/2040	4,594,000.00
27.	15/09/2040	4.594,000.00
28.	15/03/2041	4,594,000.00
29.	15/09/2041	4,594,000.00
30.	15/03/2042	4,594,000.00
31.	15/09/2042	4,594,000.00
32.	15/03/2043	4,594,000.00
33.	15/09/2043	4,594,000.00
34.	15/03/2044	4,594,000.00
35.	15/09/2044	4.594,000.00
36.	15/03/2045	4,594,000.00
37.	15/09/2045	4,594,000.00
38.	15/03/2046	4,594,000.00
39.	15/09/2046	4.594.000,00
40.	15/03/2047	4,594,000.00
	TOTALI	